

22.02.2021
Ora 17:09

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Shqiptare Atdheu për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, O.Peto**
- **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**
- **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.I.Celibashi: Mirëmbërëma të gjithëve! Atëherë, fillojmë seancën publike të shqyrtimit të çështjeve nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në rend të ditës sot janë disa kërkesa për regjistrim të partive politike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e 25 Prill 2021. Kemi shqyrtimin e kërkesës së Partisë Shqiptare Atdheu. Kërkesën e Partisë Pajtimit Kombëtar. Kërkesën e Partisë Ligj dhe Drejtësi, Partisë Fryma e Re Demokratike, Partisë Qytetare Shqiptare, Partisë Unitetit Kombëtar, Partisë Aleanca Kuq e Zi, Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, Partisë Aleanca Popullore. Kemi kërkesën për regjistrim të komitetit nismëtar për paraqitjen e kandidaturës së Kreshnik Mexhani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit. Komiteti nismëtar për paraqitjen e kandidaturës së propozuar nga zgjedhësit të zotit Bledar Dika. Kërkesën për shqyrtim të Partisë Centriste të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

Mirëqënies Popullore Shqiptare. Kërkesën për regjistrim si subjekt zgjedhor të Partisë Punës së Shqipërisë. Kërkesën për regjistrim si subjekt zgjedhor të Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë. Kërkesën e Partisë Emigracionit Shqiptar. Mos e kemi dy herë këtë?

(nuk dëgjohet)

Kemi dhe projektvendimin që lidhet me caktimin e zonës zgjedhore numër 38 Bashkia Tiranës si njësi administrative ku do të zbatohet projekti për votimin dhe numërimin elektronik të votave.

Z.Y.Merkaj: Zoti Kryetar kemi një kërkesë për shtimin e rendit të ditës. Kemi Komitetin Shqiptar të Helsinkit i cili ka paraqitur kërkesë për akredimin e vëzhguesve. Kështu që propozoj të shtohet si pikë e rendit të ditës.


Z.I.Celibashi: Po, dakord shtojmë në rendin e ditës edhe kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit për akreditimin e disa vëzhguesve afatgjatë nëse nuk gaboj.

Z.Y.Merkaj: Po.

Z.I.Celibashi: Mirë, atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së Partisë Shqiptare Atdheu.

Z.Y.Merkaj: Partia Shqiptare Atdheu ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend të datës 25 Prill 2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me Nenin 64 dhe 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

dhe si e tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Mirë, atëherë meqenëse dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës së Partisë Shqiptare Atdheu për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor është në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor, vendos:

- 1.Të regjistroj si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 Partinë Shqiptare Atdheu.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.83

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

22.02.2021

Ora 17:12

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Pajtimit Kombëtar për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, O.Peto**

• **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**

• **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë tek pika e dytë e rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Partia Pajtimit Kombëtar ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që është në përputhje me Nenin 64 dhe 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor dhe si e tillë kërkesa e kësaj partie duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

Z.I.Celibashi: Dakord, atëherë meqenëse edhe kërkesa, edhe dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës së Partia Pajtimit Kombëtar për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor është në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor, vendos:

1.Të regjistroj si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 Partia Pajtimit Kombëtar, me kryetar zotin Spartak Dobi, me shkronjat nistore PPK.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.84

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

22.02.2021
Ora 17:13

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Ligj dhe Drejtësi për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, O.Peto**

• **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**

• **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.Y.Merkaj: Partia Ligj dhe Drejtësi ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me Nenin 64 dhe 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor dhe si e tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës të paraqitur nga kjo parti, faleminderit!.

Z.I.Celibashi: Faleminderti! Atëherë, meqenëse kërkesa dhe dokumentacioni bashkëshoqërues i Partia Ligj dhe Drejtësi është në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor, vendos:

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

- 1.Të regjistroj si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 Partia Ligj dhe Drejtësi, me kryetar zotin Spartak Ngjela, me shkronjat nistore PLIDR.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.85

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*



22.02.2021
Ora 17:14

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Fryma e Re Demokratike për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, O.Peto**
- **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**
- **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.Y.Merkaj: Partia Fryma e Re Demokratike ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Nga ana juridike dokumentacioni konstatohet se është në përputhje me Nenin 64 dhe 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor dhe si e tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës.

Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Dakord! Atëherë, meqenëse kërkesa është në përputhje me parashikimet e ligjit.. kërkesa e Partisë Fryma e Re Demokratike për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor, vendos:

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

- 1.Të regjistroj si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 Partia Fryma e Re Demokratike, me kryetar zotin Bamir Topi, me shkronjat nistore FRD.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.86

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*



22.02.2021
Ora 17:15

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Qytetare Shqiptare për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, O.Peto**
- **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**
- **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.Y.Merkaj: Partia Qytetare Shqiptare ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me Nenin 64 dhe 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor dhe si e tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës të paraqitur nga kjo parti.

Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Meqenëse kërkesa është në përputhje me parashikimet e ligjit, vendos:

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

- 1.Të regjistroj si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 Partia Qytetare Shqiptare, me kryetar zotin Joan Vetko, me shkronjat nistore PQSH.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.87

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

22.02.2021
Ora 17:16

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Uniteti Kombëtar për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, O.Peto**
- **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**
- **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.Y.Merkaj: Partia Unitetit Kombëtar ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga kjo parti është në përputhje me kriteret e përcaktuar në Nenin 64 dhe 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor dhe si e tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës të paraqitur nga kjo parti.

Faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

Z.I.Celibashi: Faleminderit!

Atëherë, meqenëse kërkesa e Partisë Unitetit Kombëtar dhe dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor është në përputhje me parashikimet e kodit, vendos:

- 1.Të regjistroj si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 Partia Unitetit Kombëtar, me kryetar zotin Idajet Beqiri, me shkronjat nistore PUK.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.88

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

22.02.2021

Ora 17:17

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Aleanca Kuq e Zi për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021”

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Z.Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto, E.Allushi

• **Parti Politike: LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**

• **Vëzhgues: KSHH (Daniel Prroni)**

Z.I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Partia Aleanca Kuq e Zi ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me nenin 64, dhe 92/2 pika 2 të Kodit Zgjedhor dhe si e tillë kërkesa duhet pranuar. Bashkëlidhur keni projektvendimin dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z.I. Celibashi: Po meqenëse kërkesa është në përputhje me parashikimet e ligjit, po kështu dhe dokumentacioni përkatës, vendos:

1.Të regjistroj si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 Partia Aleanca Kuq e Zi me kryetare Znj.Lumturi Ratkoceri me shkronjë nistore AK.

1

*Zbardhi materialin e inçizuar
Arlinda BAHOLLARI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.89

*Zbardhi materialin e inçizuar
Arlinda BAHOLLARI*



22.02.2021
Ora 17:17

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, O.Peta,**
- **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**
- **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.I. Celibashi: Pika tjetër.

Z.Y.Merkaj: Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve është në përputhje me nenin 64, 92/2 pika 2 të Kodit Zgjedhor dhe si e tillë duhet pranuar. Bashkëlidhur projektvendimi për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacioni përkatës paraqitur nga kjo parti, faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

Z.I. Celibashi: Mirë, edhe për këtë parti meqenëse kërkesa është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, vendos:

- 1.Të regjistroj si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve me kryetar Z.Ymer Kurti me shkronja nistore TMDE.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.90

*Zbardhi materialin e inçizuar
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

22.02.2021

Ora 17:18

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Aleanca Popullore për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Z.Illirjan Celibashi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

2.Stafi KQZ: Z.Y.Merkaj, , M.Koja, O.Peto

Parti Politike: LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)

Vëzhgues: KSHH (Daniel Prroni)

Z.I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z.Y.Merkaj: Partia Aleanca Popullore ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia Aleanca Popullore është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64 dhe 92/2 pika 2 të Kodit Zgjedhor dhe si e tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Arlinda BAHOLLARI*

1



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

Z.I. Celibashi: Po, meqenëse kërkesa për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor dhe dokumentacioni bashkëshoqërues i Partisë Aleanca Popullore është në përputhje me parashikimet e ligjit, vendos:

- 1.Të regjistroj si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, Partia Aleanca Popullore me kryetar Z.Artur Dojaka me shkronja nistore AP.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.91

*Zbardhi materialin e inçizuar
Arlinda BAHOLLARI*



22.02.2021
Ora 17:19

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e komitetit nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z. Kreshnik Merxhani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto, E.Allushi**

• **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**

• **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.I. Celibashi: Pika e rradhës.

Z.Y.Merkaj: Bazuar në nenin 69 në zgjedhjet e zonës zgjedhore Qarku Gjirokastrë kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për krijimin e komitetit nismëtar, për organizimin e punës për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin Kreshnik Merxhani. Pas verifikimit të dokumentacionit konstatohet se dokumentacioni i paraqitur nga anëtarët e komitetit nismëtar është në përputhje me nenin 69 të Kodit Zgjedhor dhe si e tillë duhet të pranohet kërkesa për krijimin e komitetit nismëtar. Bashkëlidhur kemi projektvendim për shqyrtim dhe miratim.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Arlinda BAHOLLARI*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

Z.I. Celibashi: Mirë, meqenëse dokumentacioni i paraqitur nga komiteti nismëtar për regjistrimin e kandidatit të pavarur nga zgjedhësit është në përputhje me parashikimet e ligjit, vendos:

1. Regjistrimin e komitetit nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e zotit Kreshnik Luan Merxhani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.92

*Zbardhi materialin e inçizuar
Arlinda BAHOLLARI*



22.02.2021
Ora 17:21

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e komitetit nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z. Bledar Dika si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto, E.Allushi**

• **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**

• **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z.Y.Merkaj: Bazuar në nenin 69 të Kodit Zgjedhor, 90 persona zgjedhës të zonës zgjedhore Qarku Tiranë kanë depozituar kërkesën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e komitetit nismëtar, për organizimin e punës, për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin zotin Bledar Dika. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me nenin 69 të Kodit Zgjedhor

1

*Zbardhi materialin e inçizuar
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

dhe si e tillë duhet të pranohet. Bashkëlidhur keni projektvendimi për shqyrtim dhe miratim, si dhe emrat e verifikuar të komitetit nismëtar, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit, meqenëse kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues i këtij komiteti nismëtar është në përputhje me parashikimet e ligjit, vendos:

- 1.Regjistrimin e komitetit nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e zotit Bledar Konstandin Dika si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.93

*Zbardhi materialin e inçizuar
Arlinda BAHOLLARI*



22.02.2021
Ora 17:22

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Centriste të Mirëqenies
Popullore Shqiptare për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për
Kuvendin të datës 25 Prill 2021”**

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto, E.Allushi**

• **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**

• **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.I. Celibashi: Vazhdojmë pikën tjetër.

Z.Y.Merkaj: Partia Centriste e Mirëqenies Popullore Shqiptare ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64 pika 2 shkronja “e” të Kodit Zgjedhor. Drejtuar dispozitave të mësipërme Partia Centriste e Mirëqenies Popullore Shqiptare nuk ka depozituar deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn sipas modelit zgjedhor 01 si dhe rradhën e numrit të llogarisë së posaçme sipas deklaratës modeli 01/1 të miratuar me udhëzimin numër 1 të vitit 2020, “Për

1

*Zbardhi materialin e inçizuar
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

caktimin e rregullave për depozitimin e shpjegimit të listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”. Edhe diçka, që i është kërkuar kryetarit të kësaj partie si depozitë për të plotësuar dokumentacionin. Përsëri pas kalimit të afatit 2 ditor të përcaktuar me kërkesën tonë, nuk është plotësuar kërkesa për të hapur numrin e llogarisë bankare në emër të kryetarit të partisë. Në këto kushte administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve propozon të mos regjistrohet Partia Centriste e Mirëqenies Popullore Shqiptare, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.

Z.I. Celibashi: Ne kemi komunikuar me përfaqësuesit e kësaj partie dhe nuk i janë përgjigjur kërkesës së KQZ-së për të plotësuar dokumentacionin që ishte mangët?

Z.Y.Merkaj: Kemi folur me kryetarin e partisë.

Z.I.Celibashi: Nga përfaqësuesit e partive politike ka ndonjë diskutim?


Z.A.Kaziaj: Nuk kemi asgjë.

Z.I.Celibashi: Mirë, atëhere meqenëse Partia Centriste e Mirëqenies Popullore Shqiptare nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë në përmbushje të kërkesave të ligjit për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor, vendos:

- 1.Të mos regjistroj si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 Partia Centriste e Mirëqenies Popullore Shqiptare me kryetar z.Vladimir Lulaj me shkronja nistore PCMP SH.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.94

*Zbardhi materialin e inçizuar
Arlinda BAHOLLARI*



22.02.2021
Ora 17:24

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë së Punës së Shqipërisë për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Z.Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto, E.Allushi


• **Parti Politike: LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**

• **Vëzhgues: KSHH (Daniel Prroni)**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e kërkesës së Partisë së Punës së Shqipërisë.

Z.Y.Merkaj: Partia e Punës së Shqipërisë ka depozituar kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet që dhe kjo parti nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64 dhe 92/2, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Pasi ligji parashikon hapjen e llogarisë së posaçme në banka, nga subjekti zgjedhor. Kjo kërkesë e ligjit nuk është plotësuar nga kryetari i kësaj partie. Edhe pas kërkesës që ne u kemi bërë për plotësim dokumentacioni, përsëri kryetari i kësaj partie, nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të ligjit për të hapur një numër llogarie të posaçme. Në kushtet kur nuk ka plotësuar dokumentacionin ju paraqesim kërkesën për

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

mosregjistrim të Partisë së Punës së Shqipërisë, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.

Z.I.Celibashi: Edhe me këta kemi pas komunikim për të plotësuar dokumentacionin dhe nuk i janë përgjigjur kërkesës për plotësim dokumentacioni?

Z.Y.Merkaj: Po!

Z.I.Celibashi: Mirë, atëherë meqenëse dokumentacioni nuk është i plotë, vendos:


1.Të mos regjistroj si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, Partia e Punës së Shqipërisë me kryetar zotin Bardhyl Hazizi me shkronja nistore PPSH.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.95

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



22.02.2021
Ora 17:25

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**
- **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e kërkesës së Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë.

Z.Y.Merkaj: Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë ka depozituar kërkesën në KQZ, për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet që dhe kjo parti nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 92/2, pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili flet për hapjen e llogarisë së posaçme në banka, nga subjekti zgjedhor. Pas komunikimit me kryetarin e kësaj partie dhe për caktimin e afatit të lënë në shkresën e dërguar kryetarit të partisë, përsëri nuk është plotësuar dokumentacioni dhe nuk është hapur një llogari e posaçme sipas modeli 1/1 të miratuar në udhëzimin nr.1. Në këto kushte propozojmë që dhe kjo

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*


parti të mos regjistrohet si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

Z.I.Celibashi: Mirë, meqenëse dhe ky subjekt politik nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë sipas kërkesave të ligjit për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor, vendos:

- 1.Të mos regjistroj si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë me kryetar zotin Kadri Isufaj me shkronja nistore PMDPSH.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.96

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



22.02.2021
Ora 17:27

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqytimin e kërkesës së zotit Xhavit Zhuzhi për regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë Emigracioni Shqiptar, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**
- **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Zoti Xhavit Zhuzhi, me pretendimin si Kryetar i Partisë Emigracioni Shqiptar, ka depozituar kërkesën dhe dokumentacionin në KQZ, për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Pas verifikimit, konstatohet se dokumentacioni i paraqitur nga zoti Xhavit Zhuzhi nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Pas komunikimit me zotin Xhavit Zhuzhi i kemi kërkuar plotësimin e dokumentacionit për regjistrim. Nga ana e tij nuk është plotësuar ky dokumentacion, pasi nuk ka sjellë vërtetimin e Zyrës së Regjistrimit të Partive, që figuron si kryetar i kësaj partie, pasi është një person tjetër. Në këto kushte pas verifikimit të dokumentacionit konstatohet se zoti Xhavit Zhuzhi nuk legjitimohet

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

të jetë kryetar i kësaj partie dhe nuk mund të regjistrohet si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Pra, jemi para rastit ku dikush ka paraqitur një kërkesë për regjistrimin e një partie politike dhe s'ka lidhje fare me atë parti politike?

Z.Y.Merkaj: Ka pasë një mosmarrëveshje me Kryetarin aktual..

Z.I.Celibashi: Por zyrtarisht nuk ekziston në regjistrat e gjykatës?

Z.Y.Merkaj: Në regjistrat e gjykatës figuron zoti Kostaq Papa kryetar i kësaj partie, kështu që është regjistruar si parti më parë. Pretendimi i zotit Xhavit rrëzohet, bie.

Z.I.Celibashi: Dakord, atëherë bazuar në sa u relatua, vendos:

1.Mospranimin e kërkesës nga zoti Xhavit Zhuzhi për regjistrimin e Partisë Emigracioni Shqiptar, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.97

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



22.02.2021

Ora 17:29

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e kërkesës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit, për akreditim të vëzhguesve afatgjatë në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto, E.Allushi**

- **Parti Politike:** **LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**

- **Vëzhgues:** **KSHH (Daniel Prroni)**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 18 vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Komiteti Shqiptar i Helsinkit është organizatë jo-qeveritare e specializuar dhe angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për funksionimin e shtetit ligjor si dhe monitorimin e zgjedhjeve. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në mbështetje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e 18 vëzhguesve afatgjatë, faleminderit!

1

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.02.2021*

Z.I.Celibashi: Atëherë meqenëse dokumentacioni i paraqitur nga organizata Komiteti Shqiptar i Helsinkit për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin në datën 25 Prill 2021 është në përputhje me parashikimet e ligjit si dhe me udhëzimin nr.2 të KQZ, vendos:

1.Të miratoj kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit për akreditimin e 18 vëzhguesve afatgjatë për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.98

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

